

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO: Angazhimi për sigurinë në Kosovë mbetet i palëkundur
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/nato-angazhimi-per-sigurine-ne-kosove-mbetet-i-palekundur-i474277
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 20:41:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 20:35:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c9cbfa61513a2f032099bd9f1505051b160f6ceae08f5a0c946e9a7825dfae4
TEKSTI	f2feac71f5290e707e0bb14bac2c5fb546800bf7112244ade96f2ae4abdbf773
PAMJA	0e289a0ad865f277d67c35c9b21b716793c68ceca08270659a711c51a3ab6ccb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e7a0c53ce0cda0a673749d8a2f2f92552fbad419583d843c9998f5cb9b0d6187
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e7a0c53ce0cda0a673749d8a2f2f92552fbad419583d843c9998f5cb9b0d6187>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

NATO: Angazhimi për sigurinë në Kosovë mbetet i palëkundur



15 Shtator 2026, 22:35, Kosova & Bota CNA



NATO ka rikonfirmuar se angazhimi për sigurinë në Kosovë mbetet "i palëkundur", duke theksuar se misioni paqeruajtës i saj, KFOR është i gatshëm t'iu përgjigjet "një sërë skenarësh të sigurisë".

Pas takimit të komandantit të KFOR-it, Ozgan Ulutash me Këshillin e Atlantikut të Veriut, aleanca tha se Ballkani Perëndimor është një rajon me rëndësi strategjike për të.

"Angazhimi i aleancës për të mbështetur sigurinë afatgjatë në Kosovë dhe stabilitetin rajonal mbetet i palëkundur", tha NATO-ja.

Aleanca ushtarake perëndimore tha se Ulutash njoftoi Këshillin për përpjekjet e KFOR-it.

"Ai ndau gjithashtu pikëpamjet e tij për përpjekjet e vazhdueshme për të optimizuar dislokimin e KFOR-it, proces që vjen si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të situatës së sigurisë në Kosovë. Procesi i optimizimit synon të sigurojë që misioni të mbetet i aftë për përbushjen e detyrës. Ai bazohet në kushtet në terren, po zbatohet gradualisht dhe do të jetë plotësisht i kthyeshem, nëse zhvillimet përkatëse të sigurisë e kërkojnë një gjë të tillë", u tha në njoftimin e aleancës ushtarake perëndimore.

Për shkak të përmirësimit të situatës së sigurisë në terren, më herët NATO-ja ka njoftuar se do të zvogëlojë praninë e saj në Kosovë, por ka paralajmëruar se vendimi mund të zhbëhet, varësisht nga situata e sigurisë.

Të martën, NATO tha se KFOR-i do të vazhdojë të ketë numrin e duhur të personelit, pajisjeve, trajnimeve dhe organizimit për të zbatuar "mandatin dhe do të ruajë kapacitetet, gatishmërinë dhe fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur një sërë skenarësh të sigurisë".

"NATO-ja vazhdon gjithashtu të mbështetë fuqishëm dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, si kornizë për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, duke respektuar të drejtat e të gjitha komuniteteve", tha NATO-ja.



Njoftimi vjen një ditë pasi shefi i NATO-s, Mark Rutte, po ashtu deklaroi në Bruksel se përkushtimi i aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë do të mbetet i pandryshuar.

Sipas Ruttes, KFOR-i është në aty, në Kosovë, për të siguruar që NATO-ja të kontribuojë në stabilitet dhe paqe, ndërsa misioni paqeruajtës i aleancës, sipas tij, ka kontribuar për më shumë se dy dekada në kriimin e një miedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë.

"Kjo vlen edhe sot, pavarësisht se çfarë lajmesh mund të vijnë këtë javë ose në periudhën e ardhshme, por edhe sa i përket zotimit afatgjatë për paqe dhe siguri në Kosovë", tha Rutte më 14 shtator kur u pyet nga gazetarët nëse është i shqetësuar për trazira të dhunshme të mundshme në Kosovë dhe rajon si rezultat i vendimit nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, pavarësisht se si do të jetë ai.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin më 16 shtator aktgjykimin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, në rastin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katërt janë deklaruar të pafajshëm për dhjetë pikat e aktakuzës.

Në prag të shpalljes së aktgjykimit, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës kanë këshilluar shtetasit e tyre në Kosovë që të shmangin lëvizjet më 16 shtator, duke argumentuar se ka paralajmërime për tubime dhe demonstrata të mundshme./REL



Të sugjeruara

[Inspektori i Pentagonit: Lufta në Iran ka çuar në mungesë të municioneve në SHBA](#)

[PE-ja kritikon ashpër Serbinë për Mlladiçin](#)

[Dy marinarë të zhdukur pas sulmit me anije cisternë në Ngushticën e Hormuzit](#)

[Sanders, thirrje SHBA-ve dhe Kinës: Të negociohet një traktat mbi sigurinë e inteligjencës artificiale](#)

[BE thotë se qëndron përkrah sovranitetit dhe integritetit territorial të Bosnjës](#)

[Bllokimi i kufizimit të votimit me postë/ Trump kritika Gjykatës Supreme](#)

[Zgjedhjet/ Lawton: Kemi dyshime se do të ketë ndërhyrje të kriminelit të luftës](#)

[LVV e LDK pezullojnë bisedimet për presidentin](#)

[Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me SHBA-në](#)

[Kufizimi i votimit me postë/ Gjykata Supreme bllokoi planin e Trump](#)

[Nesër gjyqi në Hagë/ Kush janë gjyqtarët që kanë në dorë fatin e ish-krerëve të UÇK-së](#)

[Dy anije peshkimi goditen me dronë në Gjirin Persik/ Disa persona të zhdukur](#)

["Aleanca unike" me delegacion/ BE do të hapë zyrë në Kanada](#)

[Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme/ NATO rrëzon një dron në Lituani](#)

[SHBA-ja konfirmon për herë të parë se ka vendosur armë në hapësirë](#)

Hetimet për korrupsion/ Zelensky kërkon shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm të Ukrainës

Paralajmërimi se IA mund të shkatërrojë njerëzimin/ Trump: Është një mashtrim

Vuçiq: Do të jap dorëheqjen si president më 27 shtator


Marrëveshja e njoftuar nga Trump/ Zelensky: Dyshoj në gatishmërinë e Rusesë për ta zbatuar

U propozua nga LVV dhe LDK/ Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president
[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

17:17 Opinione Elvi FUNDO

Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit

15:08 Opinione Ardi Stefa

Do flakë në Gerdë në listën e fshatrave të vendësimit të Muzant Haxhalli në Vlorë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.